



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM FIER

Fier më 02.07.2025

PROCESVERBAL

Për zhvillimin e fazës së verifikimit dhe seleksionimit paraprak të kandidatëve për konkurrim për për pozicionin “Sekretare pranë Prokurorëve” në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier në zbatim të neneve 70 – 83 e vijues të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, mbi bazën e strukturës organike të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier” Nr.19, datë 31.01.2024, me qëllim plotësimin e vendit vakant “sekretare pranë Prokurorëve” ka publikuar në faqen zyrtare në internet më datë 16.12.2024 “Njoftim për shpalljen e konkurimit për lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil për një vend të lirë në punë në pozicionin“ Sekretare pranë Prokurorëve” në Prokurorinë Fier”.

Nga komisioni për vlerësimin e kandidaturave, kandidatët që kanë aplikuar për pozicionin “Sekretare pranë Prokurorëve” në Prokurorinë Fier“, rezultoi të jenë si më poshtë;

Lista e kandidatëve që kanë aplikuar:

1. Znj.Ylvie Kuka
2. Z.Neriklid Muskaj

Komisioni për vlerësimin e kandidaturave, pas rishikimit të dokumentave për pozicionin “sekretare pranë Prokurorëve” në Prokurorinë Fier“, listoi kandidatët të cilët u përzgjodhën mbi bazën e dokumentave të paraqitura nga konkurrentët dhe gjetën pasqyrim emrat e konkurrentëve që plotësojnë nga ana dokumentare kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në “Shpallje për lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil”.

Lista e Kandidatëve të kualifikuar:

1. Znj.Ylvie Kuka
2. Z.Neriklid Muskaj

Ngarkohet Kryesekretaria që të bëhet njoftimi i dy kandidateve që me datë 09.07.2025, ora 11:00 të paraqiten në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier për të vijuar me fazën e dytë, testimi i njohurive teorike.

Anëtar të Komisionit
Kristi Jorgji

Kryetari i Komisionit
Petrît Vukaj

Anëtar të Komisionit
Klaudia Mino